



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Lënda: Propozime ligjore ne Kushtetutë dhe disa ligje të reformës.

KUVENDIT TË SHQIPËRISË

KOMISIONIT TË LIGJEVE

TIRANË

A- PROPOZIME PËR NDRYSHIME NË LIGJIN NR.115/2016,

M

1. Programi i Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës me kohëzgjatje 3 vjet të bëhet në 2 vjet, për një periudhë tranzitore.

Sipas këtij propozimi synohet vendosja e një parashikimi të ri ligjor që të rregullojë, përjashtimisht, *për një periudhë tranzitore*, zhvillimin e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në një kohëzgjatje prej 2 vitesh. Kjo nënkupton shkrirjen e vitit të praktikës para-profesionale me vitin e praktikës profesionale (*respektivisht, shkrirjen e vitit të dytë me vitin e tretë*), të programit aktual të studimit në Formimin Fillestar.

Periudha tranzitore sipas këtij propozimi do të ishte, me fillim nga viti akademik 2020 - 2021 deri përfundimin e mandatit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Vëmë në dukje se, rregullimet aktuale ligjore të programit 3-vjeçar të Formimit Fillestar do të vijojnë të zbatohen për studentët e Vitit të 1-rë, Vitit të 2-të dhe Vitit të 3-të, që aktualisht ndjekin studimet si dhe për studentët që do të ndjekin studimet pas përfundimit të periudhës tranzitore (përfshirë vitin akademik 2020 - 2021).

Mënyra e pranimit, zhvillimit të studimeve dhe vlerësimit të kandidatëve për magistratë (prokurorë ose gjyqtarë) rregullohet në nenet 263 e vijues të ligjit Nr.115/2016, i ndryshuar.

1. Në nenin 263, të **Ligjit Nr.115/2016, i ndryshuar**, parashikohet se:

“1. Formimi fillestar i kandidatëve për magistratë përfshin një periudhë trevjeçare që përbëhet nga:

a) një vit program teorik që synon të rrisë njohuritë në lëndë të ndryshme të së drejtës;

b) një vit program praktik paraprofesional, që synon të rrisë aftësitë praktike të kandidatëve si gjyqtarë dhe prokurorë nën kujdesin e shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori me kualifikim të lartë;

c) një vit praktikë profesionale që do të organizohet sipas mënyrës dhe afateve

ρ ρ ρ ρ δ ρ ρ ρ
ρ

2. Programi i trajnimit, i parashikuar sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, është i përbashkët për të gjithë kandidatët dhe organizohet, ndiqet e drejtohet nga Shkolla e Magistraturës. Viti i praktikës paraprofesionale zhvillohet sipas profileve që ka zgjedhur kandidati si gjyqtar ose prokuror”

Në nenin 268 të këtij ligji, përcaktohen kriteret dhe procedurat për vlerësimin e formimit fillestar për kandidatët për magistratë, referuar programit aktual 3-vjeçar të Formimit Fillestar. Këto kritere dhe procedura mund të aplikohen edhe për vlerësimin e kandidatëve për magistratë në periudhën tranzitore të programit të Formimit Fillestar me kohëzgjatje 2-vjeçare.

2. Mënyra e vlerësimit të praktikës profesionale për kandidatët për magistratë.

Ndërsa, në nenin 269, të ligjit, përcaktohet mënyra e vlerësimit të praktikës profesionale për kandidatët për magistratë, referuar programit aktual 3-vjeçar të Formimit Fillestar. Kjo mënyrë vlerësimi mund të aplikohet edhe për vlerësimin e kandidatëve për magistratë në periudhën tranzitore të programit të Formimit

Fillestar me kohëzgjatje 2-vjeçare.

3. Çështja e trajtimit me bursë të kandidatëve për magistratë si dhe mënyra e kryerjes së praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë.

Në nenet 19, pika 1, dhe 33, të **Ligjit Nr.96/2016, i ndryshuar**, rregullohen çështja e trajtimit me bursë të kandidatëve për magistratë si dhe mënyra e kryerjes së praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë.

Duke qënë se, për periudhën tranzitore, programi i Formimit Fillestar do të zhvillohet në 2 vite sugjerojmë që, niveli i bursës gjatë vitit të dytë në periudhën tranzitore të jetë 45 për qind të pagës bruto fillestare të magistratit.

Po ashtu, rregullat e tjera të nenit 19, do të zbatohen për kandidatët për magistratë në periudhën tranzitore.

Po kështu, në nenin 33, të këtij ligji, parashikohet mënyra e kryerjes së praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë. Në pikën 1, të këtij neni parashikohet se:

“1. Kandidatët gjyqtarë dhe kandidatët prokurorë kryejnë praktikën profesionale, përkatësisht, në gjykata dhe në prokurori, në vitin e tretë të formimit fillestar. Praktika profesionale zgjat 12 muaj, duke filluar në muajin korrik dhe përfundon në muajin qershor të vitit pasardhës....”

Për të njëjtën arsye si më sipër është e nevojshme që, të shtohet një rregullim i ri ligjor sipas së cilit, kandidatët gjyqtarë dhe kandidatët prokurorë të kryejnë praktikën profesionale në periudhën përkatëse të vitit të dytë të Programit Fillestar në periudhën tranzitore, sipas rregullave të nenit 33, të këtij ligji.

Për miratimin e propozimit të mësipërm, sugjerojmë ndryshimet në ligjet si vijon:

Në Kreun VI, “Dispozitat e fundit”, të Ligjit Nr.115/2016, i ndryshuar, të shtohet

një nen i ri, me Nr.263/1, i titulluar “Programi i formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë në periudhën tranzitore”, me këtë përmbajtje:

Neni 263/1

*Programi i formimit fillestar i kandidatëve për magjistratë
në periudhën tranzitore*

- *Programi i Formimit Fillestar të kandidatëve për magjistratë për periudhën që përfshin vitin akademik nga 2020 e në vijim, deri në përfundimin e mandatit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, do të ketë një kohëzgjatje prej 2 vitesh.*
- *Viti i praktikës paraprofesionale dhe viti i praktikës profesionale sipas nenit 263, pika 1, gjerat “b” dhe “c”, të këtij ligji, do të realizohen gjatë vitit të dytë të programit të Formimit Fillestar, sipas këtij neni.*
- *Koha që do të zërë ndjekja e praktikës paraprofesionale dhe praktikës profesionale sipas nenit 263, pika 1, gjerat “b” dhe “c”, të këtij ligji, do të ndahet në mënyrë të barabartë gjatë vitit të dytë të programit të Formimit Fillestar.*
- *Vlerësimi i formimit fillestar për kandidatët për magjistratë sipas nenit 268, të këtij ligji, do të zbatohet edhe për vlerësimin e kandidatëve për magjistratë në periudhën tranzitore.*
- *Vlerësimi i praktikës profesionale për kandidatët për magjistratë sipas nenit 269, të këtij ligji, do të zbatohet edhe për vlerësimin e kandidatëve për magjistratë në periudhën tranzitore.*
- *Rregullat e tjera që kanë të bëjnë me trajtimin e kandidatëve për magjistratë sipas këtij ligji, zbatohen në mënyrë proporcionale edhe për kandidatët për magjistratë në periudhën tranzitore.*

**B- PROPOZIME PËR NDRYSHIME NË LIGJIN NR.96/2016,
STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË**

Propozimi Nr.1

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese të vitit 2016 ka miratuar ligjin Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i cili përcakton parimet dhe rregullat në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi si dhe të Shkollës së Magjistraturës.

Si dhe ligjin Nr.96/2016, "Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë" i cili vendos një sistem garancish ligjore në funksion të pavarësisë dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor me qëllim ndërtimin e një sistemi drejtësie të pavarur, të paanshëm, të përgjegjshëm, të drejtë e profesional, të besueshëm dhe të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarit.

Në seicilin prej ligjeve të sipërcituara, legjislatori ka vlerësuar se parashikimi kushtetues në lidhje me vijueshmërinë e karrierës së anëtarit prokuror të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pas përfundimit të mandatit, është i pamjaftueshëm.

Kështu në pikën 10 të nenit 149 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet ndër të tjera se: “... Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhje të njëpasnjëshme. **Në përfundim të mandatit, anëtarët prokurorë kthehen në vendet e mëparshme të punës...**”

Pra kushtetuta parashikon se me përfundimin e mandatit si anëtar Këshilli, magjistrati prokuror kthehet në vendin e mëparshëm të punës, por ndërkohë me ligjin Nr.115/2016 dhe ligjin Nr.96/2016 janë parashikuar kufizime shtesë në lidhje me faktin se si do të zhvillohet karriera e këtij magjistrati pasi ai të kthehet në vendin e mëparshëm të punës, parashikime për të cilat kërkohen ndryshime.

Në nenin 102 i ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikohet ndër të tjera se:

4. *Anëtari prokuror i Këshillit nuk mund të transferohet, të ngrihet në detyrë ose të delegohet gjatë tre viteve pas përfundimit të mandatit....*”

Në ligjin Nr.96/2016, "Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë" në dispozita të ndryshme të tij parashikon të njëjtin kufizim për zhvillimin e karrierës së anëtarit prokuror të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Përkatësisht:

Pika 3 e nenit 43 të këtij ligji parashikon:

“3. Kandidati që ka ushtruar funksionin si anëtar i Këshillit, përjashtohet nga procedura e lëvizjes paralele gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si anëtar, si dhe tre vjet pas mbarimit të mandatit.”

Pika 6 e nenit 47 të këtij ligji parashikon:

“6. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë së shkallës së parë ose të dytë, nëse:

.....

c) nuk ka qenë anëtar i Këshillit në tre vitet e fundit.”

Pika 4 dhe 9 e nenit 48 të këtij ligji parashikon:

“4. Kandidati që ka ushtruar funksionin si anëtar i Këshillit, përjashtohet nga procedura e ngritjes në detyrë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si anëtar, si dhe tre vjet pas mbarimit të mandatit

9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme:

a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh:

i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi;...”

Garancitë kushtetuese dhe ligjore për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit lidhen kryesisht me mënyrën e emërimit të tyre, të menaxhimit të karrierës, qëndrimit në detyrë, përfitimeve financiare dhe jo financiare të magjistratit gjatë ushtrimit të

detyrës dhe pas përfundimit të detyrës si dhe me institucionet e ngarkuara për garantimin e këtyre të drejtave.

Ligji Nr.96/2016 rregullon në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve, ku gjejnë trajtim të veçantë të drejtat që kanë të bëjnë me zhvillimin e karrierës së magjistratëve ku trajtohen çështje të rekrutimit të kandidatëve magjistratë, emërimi dhe caktimi në pozicion, transferimi, ngritja në detyrë, komandimi, mandati i kufizuar etj.

Nëpërmjet ligjit Nr. 96/2016 synohet: Garantimi i një procesi emërimi dhe promovimi të magjistratëve, të bazuar në kritere transparente, objektive dhe meritokracie. Përcaktimi në mënyrë të detajuar i procedurave që sigurojnë përzgjedhjen e kandidatëve për magjistratë dhe konfirmimin e tyre në karrierë, duke u bazuar në kritere objektive e transparente.

Propozimi për ndryshimin e ligjeve Nr.115/2016 dhe Nr.96/2016 vetëm për pjesën e dispozitave të sipërcituara lidhet me faktin se këto parashikime, pra kufizimi i së drejtës për të zhvilluar karrierën e tij edhe tre vjet pasi i ka përfunduar mandati për anëtarin prokuror të Këshillit, janë në radhë të parë jo në përputhje me Kushtetutën dhe në radhë të dytë nuk është në përputhje me parashikimet e tjera ligjore që janë bërë për raste ~~thujse të njëjta~~.

Sa më sipër, ndryshimet ~~propozohet~~ për arsyet, si më poshtë vijon:

- a) Garantimin e të drejtave të parashikuara në nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pasi ligji aktual kufizon në mënyrë joproporcionale të drejtën e magjistratit për të zhvilluar karrierën e tij;
- b) Një përafrim sa më të përshtatshëm me parashikimet e tjera ligjore, për raste të njëjta;

A. Garantimin e të drejtave të parashikuara në nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pasi ligji aktual kufizon në mënyrë joproporcionale të drejtën e magjistratit për të zhvilluar karrierën e tij.

Çmojmë se parashikimi i bërë në ligj, se anëtari prokuror i Këshillit nuk mund të transferohet, të ngrihet në detyrë ose të delegohet gjatë tre viteve pas përfundimit të mandatit, është një kufizim i tillë që jo vetëm kufizon të drejtën e garantuar nga neni 138 dhe pika 1 e nenit 149 të Kushtetutës, por i cënon në thelb këto të drejta.

Në vendimin e saj Nr.11 datë 06.03.2014 Gjykata Kushtetuese shprehet se: “... Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, të pranuar në Kushtetutë, dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre, duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave, forcimin e shtetit ligjor. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitime të këtyre, atëherë do të dhunohet parimi kushtetues i barazisë së të drejtave dhe, në përgjithësi, do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës

Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai nuk mund të prekë ato të drejta, kufijtë e të cilave në Kushtetutë janë parashikuar shprehimisht si të pakapërcyeshme ose të kufizueshme vetëm në raste specifike. Të drejtat e tjera kushtetuese ai mund t'i kufizojë vetëm në kushtet e nenit 17 të Kushtetutës, pra, për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e të drejtës..”

Në vendimin e saj Nr.11 datë 06.03.2014 Gjykata Kushtetuese shprehet se: “

“..... Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai mund të vendosë dhe kufizime, por këto kufizime duhet të bëhen vetëm për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e të drejtës dhe garancisë Në këto kushte, Gjykata vlerëson nëse ky kufizim është vendosur nga ligjvënësi në respektim të kushteve që përcakton Kushtetuta, pra për një interes publik dhe në përpjesëtim me qëllimin që kërkohet të arrihet.

.... Gjykata, duke e vlerësuar rritjen e cilësisë së trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë nën dritën e interesit publik, e konsideron atë si shkak të arsyeshëm për ndërhyrjen konkrete të ligjvënësit.

... Lidhur me respektimin e parimit të proporcionalitetit, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se proporcionalitetin e një kufizimi ajo e vlerëson rast pas rasti duke pasur parasysh disa aspekte si, balancën mes të drejtës/garancisë së kufizuar dhe interesit publik, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën/garancinë e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Rekomandimi Nr.R (94) 12 i Këshillit të Evropës, të cilit i referohet Karta Evropiane e statusit të gjyqtarit, tregon një preferencë shumë të qartë për një sistem promovimi të bazuar në merita: "Të gjitha vendimet lidhur me karrierën profesionale të gjyqtarëve duhet të bazohen në kritere objektive dhe zgjedhja dhe karriera e gjyqtarëve duhet të bazohet në meritë, duke pasur parasysh kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin". Neni 13 i Parimeve Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e gjyqësorit shprehet se "karriera e gjyqtarëve, aty ku ekziston një sistem i tillë, duhet të bazohet në faktorë objektivë, veçanërisht në aftësitë, integritetin dhe eksperiencën". Po kështu edhe neni 9 i Kartës Universale të Gjyqtarëve parashikon se "përzgjedhja dhe emërimi i çdo gjyqtari duhet të bëhet sipas kritereve objektive dhe transparente bazuar në kualifikimin e përshtatshëm profesional". Nisur nga jurisprudenca kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare të sipërcituara, Gjykata vlerëson se karriera është një element mjaft i rëndësishëm i statusit të gjyqtarit dhe vetëm një sistem karriere i bazuar në kritere objektive garanton ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur dhe të paanshme nga ana e gjyqtarëve.

Legjislatori me qëllim për të shmangur mundësinë që anëtari të cilit i përfundon mandati, të përfitojë nga fakti se pesë ose gjashtë nga anëtarët e tjerë të Këshillit, pjesë e të cilit ai ka qenë, mund të ndikohen në vendimmarrjen për zhvillimin e karrierës së tij magjistratit, ka cënuar në thelb të drejtën e këtij magjistrati për të zhvilluar karrierën e tij.

B. Një përfrim sa më të përshtatshëm me parashikimet e tjera ligjore, për raste të njëjta.

Parashikimi se anëtari prokuror i Këshillit duhet të kthehet në vendin e mëparshëm të punës dhe se nuk mund të transferohet, të ngrihet në detyrë ose të delegohet gjatë tre viteve pas përfundimit të mandatit, nuk është në përputhje me parashikimet e tjera ligjore për raste thuajse të njëjta.

Kështu p.sh në ligjin Nr.96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" në dispozita të ndryshme të tij parashikohet:

Pikat 3 dhe 6 të neni 55 *"Komandimi i magistratëve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"*

3.Magjistrati, i cili komandohet si inspektor, konsiderohet magjistrat i ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë.

.....

6.Inspektori ka të drejtën të caktohet në një pozicion në nivel apeli në fund të përfundimit të mandatit të komandimit në rast se është vlerësuar me vlerësimin "shumë mirë" në të gjitha vlerësimet etike dhe profesionale si inspektor.

Pikat 1 dhe 4 të neni 61 *"Kufizimi i mandatit me ligj"*

"1.Mandati i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë është nëntë vjet pa të drejtë rizgjedhjeje. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm është shtatë vjet pa të drejtë rizgjedhjeje. Mandati i prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme është nëntë vjet pa të drejtë rizgjedhjeje."

4.Personat e listuar në pikën 1, të këtij neni, kanë të drejtë që pas mbarimit të mandatit të caktohen në një pozicion në nivel apeli."

Pika 1 e nenit 62 *"E drejta për caktim në nivel apeli"*

"1.Në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, si Prokuror i Përgjithshëm ose në raste të tjera, ku ligji parashikon të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli, magjistrati ka të drejtë për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion. Parashikimet e pikave 3 deri në 7, të nenit 60, të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim..."

Në nenin 203 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon se:

Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

- 1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë qëndron në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.*
- 2. Pas përfundimit të mandatit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në qoftë se në kohën e zgjedhjes punonte me kohë të plotë në sektorin publik, ka të drejtën të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose, në pamundësi, në një detyrë të barasvlershme me të.*
- 3. Në qoftë se në kohën e zgjedhjes Inspektori i Lartë ishte gjyqtar ose prokuror, ai kthehet në pozicionin e gjyqtarit ose të prokurorit të apelit.*

Sikurse shihet nga dispozitat e sipërcituara legjislatori ka parashikuar rastet e disa subjekteve, të cilët në përfundim të mandatit apo të periudhës së komandimit mund të caktohen në nivel Apeli.

Nëse i analizojmë këto raste konstatojmë se bëhet fjalë për tre kategori:

Subjektet të cilët nëpërmjet procesit të ngritjes në detyrë janë bërë pjesë e Gjykatës së Lartë apo Prokurorisë së Posaçme, të cilëve me të drejtë në përfundim të mandatit kanë të drejtë të caktohen në nivel apeli;

Subjektet të cilët nëpërmjet një procedure të posaçme konkurrimi janë zgjedhur Prokuror të Përgjithshëm apo Inspektorë të Lartë të Drejtësisë;

Magjistratët të cilët nëpërmjet procedurës së komandimit, komandohen si inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili gjatë mandatit të tij ka në kompetencë hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimeve disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillave, në përfundim të mandatit nëse ka qenë ish magjistrat i jepet mundësia të kthehet në nivel apeli. Pra jo vetëm që nuk i kufizohet mundësia për të zhvilluar karrierën, për aq kohë sa pjesë e Këshillave janë anëtarë që kanë qenë objekt i punës së ILD, por i jepet mundësia që me përparësi të caktohet në një nivel apeli.

Prokurori i Përgjithshëm, edhe nëse vjen nga radhët e juristëve, në përfundim të mandatit ka të drejtë të caktohet në nivel Apeli.

Magjistrati i Komanduar si Inspektor pranë ILD, ndonëse është caktuar me anë të një procedure komandimi dhe jo nëpërmjet një procedure të ngritjes në detyrë, pra nëpërmjet një procedure konkurrimi, në përfundim të komandimit mund të caktohet në një nivel apeli. Pra subjekti që ndihmon Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të hetojë shkeljet disiplinore ka të drejtë të caktohet në një nivel apeli ndërsa subjekti që jep masën disiplinore duhet të kthehet në vendin e mëparshëm të punës dhe nuk mund të jetë pjesë e transferimeve ngritjes në detyrë apo skemës së delegimit për tre vjet të tjera pas përfundimit të mandatit.

Në përfundim nisur nga sa u parashtrua më sipër çmojmë se në nenin 62 të Ligjit për Statusin duhet të **përfshihet një parashikim i tillë që të garantojë të drejtën e anëtarëve të këshillit që u mbaron mandati, për zhvillimin e karrierës së tyre në përputhje me parimin e proporcjonalitetit, duke përcaktuar në mënyrë taksative pozicionin se ku do të caktohet anëtari që vjen nga shkalla e parë pas përfundimit të mandatit duke shmangur në mënyrë më shumë se sa efektive, konfliktin e mundshëm të interesit.**

Ndryshimi që propozohet është si më poshtë vijon:

Pas fjalëve “**Prokuror i Përgjithshëm**” shtohen fjalët “**si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që vijnë nga radhët e gjyqtarëve/ prokurorëve të shkallës së parë**”

Propozimi Nr.2

Në nenin 11, Kreu III “**Paga dhe përfitimet e tjera financiare dhe shoqërore**”, Pjesa II “**Të drejtat dhe detyrimet e magjistratit**”, të ligjit Nr.96/2016, “*Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë*” duhet shtuar një parashikim në lidhje me pasojat që i vinë magjistratit si rezultat i emërimit larg vendbanimit.

Kështu në nenin 67 me titull “Trajtimi financiar gjatë qëndrimit në punë” të ligjit Nr.108/2014 “Për policinë e shtetit” legjislatori ka parashikuar,

1. Punonjësi i policisë, për shkak të përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë së lartë në detyrë në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, ka përparësi në trajtimin financiar, ku përfshihen:

a);

b) kompensimi për privacionet që i krijohen punonjësit të policisë për largësi nga vendbanimi, sipas kostos së transportit publik dhe paga për papunësinë e bashkëshortit/es;

c)

2. ...

Pasur në konsideratë faktin se jo në pak raste caktimi në detyrë dhe emërimi i magjistratit është larg qendrës së tij të banimit, emërim i cili mund të sjellë transferimin e të gjithë familjes së magjistratit dhe për pasojë të sjellë edhe pamundësinë për t'u punësuar të bashkëshortit të magjistratit, një parashikim dhe një garanci e tillë ligjore është më se e nevojshme.

Propozimi Nr.3

Në pikën 9 të Nenit 52 “Emërimi i kryetarëve të tjerë” të Ligjit për Statusin i cili parashikon:

“...9. Këshilli përkatës vlerëson në rast se kandidati i plotëson kriteret të parashikuara në pikën 6 të nenit 47. Ai kryen verifikim, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga ligji ose nuk kalojnë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi...”

Pas shprehjes “nuk kalojnë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës” duhet shtuar shprehja “dhe që kanë masë disiplinore në fuqi”.

Propozimi Nr.4

Parashikimi i pikës 9 të nenit 165 të Ligjit për Statusin vjen në kundërshtim me nenin 179/b të Kushtetutës dhe me frymën e Reformës në Drejtësi.

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ndër të tjera parashikon:

1. **Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi**

3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio.

4. **Të gjithë këshilltarët ligjorë** pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme **do të rivlerësohen ex officio**. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.

5. 6.....

7. **Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. Gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë ata që janë deleguar në pozicione të tjera, ish-gjyqtarë ose ish-prokurorë, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, qëndrojnë në detyrë ose emërohen gjyqtarë e prokurorë. Subjektet e tjera, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, emërohen gjyqtarë ose prokurorë, sipas ligjit...**”

Nga përmbajtja e nenit 179/b të Kushtetutës kuptohet se magjistratët si dhe këshilltarët apo ndihmësit ligjorë në detyrë do t'i nënshtrohen sistemit të rivlerësimit ex-officio dhe se moskalimi me sukses i këtij procesi do të përbëjë shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës. Nga kjo kuptohet se nëse subjekti kalon me sukses procesin e rivlerësimit duhet automatikisht të vazhdojë të qëndrojë në detyrë, detyrë për shkak të së cilës u bë subjekt i procesit të rivlerësimit. E kundërta nuk do të kishte kuptim dhe nuk do të ishte në përputhje me qëllimin për të cilin u ngrit sistemi i rivlerësimit.

Me parashikimin e bërë në fjalinë e fundit të pikës 7 të nenit 179/b të Kushtetutës, Kushtetutbërësi, nuk ka pasur si qëllim që të largojë prej sistemit të drejtësisë

subjekte të cilët nuk gëzojnë cilësinë e gjyqtarit apo të prokurorit, por ka si qëllim që, në kuadër të transparencës dhe rritjes së besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë, të evidentojë nëpërmjet mekanizmave ligjorë që çdo individ që ushtron këto detyra të rëndësishme dhe të lidhura me vendimmarrjen brenda sistemit të drejtësisë (gjykatë, prokurori), të jetë i denjë për të vazhduar ushtrimin e detyrës së gjyqtarit ose prokurorit, ose të çdo pozicioni tjetër që parashikohet sipas ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Pra, është rëndësia e detyrës që ushtrohet ose është ushtruar nga subjektet e rivlerësimit, ajo që ka përcaktuar faktin se përse personat që ushtrojnë këto detyra janë bërë subjekte të rivlerësimit.

Rivlerësimi “ex officio” i këshilltarëve ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, **Ndihmësave Ligjorë pranë Gjykatave Administrative**, ndihmësave ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme, është parashikuar jo vetëm në Kushtetutë, por edhe në ligjet e tjera që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të dispozitave të saj.

Kështu në nenin 3, pika 16 e ligjit Nr.84/2016, është parashikuar se: “*Subjekt i rivlerësimit janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës*”, ndërsa në nenin 165, pika 1 e ligjit Nr.96/2016, është parashikuar se: “*Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

Ndërkohë **pika 9 e nenit 165** të Ligjit për statusin parashikon: “*Nëse ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit në detyrë kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, por nuk ndjekin fushën e karrierës së magjistratit, kanë të drejtë*

ρ ρ ρ ρ ρ ρ

nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të tyre aktual dhe për të cilin përmbushin kriteret. Kërkesa për caktim në pozicion paraqitet respektivisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë brenda një muaji pas publikimit të rezultatit të testimit të Shkollës së

Magjistraturës. Në këtë rast marrëdhënia e punës së ndihmësit ligjor, inspektorit dhe këshilltarit të gjyqtarit në detyrë mbaron në ditën e paraqitjes së kërkesës. Ky rregull nuk zbatohet për këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të cilët vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë, nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve ligjore.”

Kjo dispozitë në kundërshtim me parashikimin e nenit 179/b të Kushtetutës parashikon se nëse këshilltari apo ndihmësi ligjor kalon me sukses procesin e rivlerësimit, por nuk zgjedh të vazhdojë karrierën si magjistrat, nuk mund të vazhdojë të qëndrojë në detyrën e ndihmësit apo këshilltarit ligjor ndonëse qëllimi i procesit të rivlerësimit ishte të vlerësonte, nëse subjektet e këtij procesi duhet ose jo të vazhdon të qëndronin në pozicionin e punës, pozicioni i cili i bëri ex-officio subjekte të procesit të rivlerësimit.

Në kushtet ku asnjë nënpunës civil në sistemin e prokurorisë apo në sistemin gjyqësor nuk i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga organet e vettingut, humbet edhe kuptimi se përse ndihmësit ligjorë apo këshilltarët ligjorë që zgjedhin të mos ndjekin karrierën si magjistrat duhej që kryesisht ti nënshtroheshin procesit të rivlerësimit,

Sa më sipër pika 9 e nenit 165 të ligjit për statusin duhet ndryshuar në përputhje me parashikimet e nenit 179/b të Kushtetutës, si më poshtë:

δ ρ δ ρ δ ρ
procesin e rivlerësimit, por nuk ndjekin fushën e karrierës së magjistratit,
δρ δ ρ

Si dhe neni 165 i Ligjit për statusin duhet të pësojë ndryshime të tilla në përputhje me parashikimin e bërë në fjalinë e fundit të pikës 7 të nenit 179/b, duke lejuar të gjithë ndihmësit ligjor me mbi 5 vjet përvojë pune në këtë detyrë që kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, të futen pa konkurs në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në profilin gjyqtar, ndërsa ndihmësit ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme në profilin prokuror. Një përcaktim i tillë në ligj jo vetëm që do hapte rrugën e karrierës për ndihmësit ligjor në detyrë, por do mundësonte që në radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të futeshin persona, të cilët do kishin një formim më të mirë

teorik e praktik dhe më të përgatitur në kryerjen e detyrës së gjyqtarit, pasi do të vinin në jetë të gjithë njohuritë dhe aftësitë profesionale të krijuara gjatë punës së përditshme në gjykatë.

Propozimi Nr.5

Në pikën 3 të nenit 166 “Dispozitat kalimtare për ish-gjyqtarë dhe ish-prokurorë” të Ligjit për Statusin i cili parashikon se:

“...8. 3. Brenda dy viteve pas kalimit me sukses të procesit së rivlerësimit, subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, riemërohen si magjistratë. Ata kanë të drejtën për t’u caktuar në një pozicion për të cilin përmbushin kriteret, sipas nenit 47, të këtij ligji, si dhe të kandidojnë në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicione për magjistratë ose për pozicione të komanduara ose pozicione që mund të ushtrohen vetëm nga magjistratët.....”

duhet ndryshuar referenca ligjore nga “sipas nenit 47” në “sipas nenit 42”.

Propozimi Nr.6

Neni 2, germa H)

Termi “ndihmësmagjistrat” mund të ndryshohet në “magjistrat ndihmës”.

Kjo për arsye se termi i parë duket sikur bëhet fjalë për një person që ndihmon magjistratët, ndërkohë që me termin e dytë del më qartë fakti që personi është magjistrat por ushtron detyra ndihmëse për subjektet e parashikuara në ligj. Nëse vendoset, duhet bërë ndryshim edhe në tekstin e ligjit ku përdoret ky term.

Propozimi Nr.7

Neni 42, pika 2 (fjalja e fundit).

Hiqet togfjalëshi “ për të paktën 3 muaj” dhe bëhet “për mbi 3 muaj”

Për të mos krijuar konfuzion dhe ngatërrim me nenin 59 kjo fjali mund të bëhet :

“Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për mbi 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.”

Propozimi Nr.8

Pika 4, gërma B)

Në gërmën b) të kësaj pike është lënë **togfjalëshi** ρ

Gjykojmë që ky togfjalësh duhet të jetë haruar për tu hequr pasi neni për papajtueshmërinë ambientale është ndryshuar krejtësisht pas shfuqizimit që i është bërë nga GJ.K. Për analogji i njëjti togfjalësh është shfuqizuar edhe në gërmën c) të pikës 1 të nenit 44. Mendojmë që duhet hequr.

Propozimi Nr.9

Neni 45, pika 1

Termi “komanduar” në këtë rast mund të zëvendësohet me termin “deleguar”, kjo për të mos krijuar konfuzion termash me komandimin si nocion në kuptim të nenit 53 e vijues si dhe për ti qëndruar në terminologji titullit të nenit.

Propozimi Nr.10

Neni 45, Pika 5

Gjykojmë që **magjistrati që është në pritje në skemën e delegimit duhet ta ushtrojë funksionin në prokurorinë ku ka emërimin dhe jo pranë strukturave të këshillit.** Kjo për arsye se ky magjistrat do të ishte inefektiv për shkak të lëvizjeve të shpeshta që mund të ketë. Për më tepër sot e për disa vite do të gjendemi në vështirësi për personel. Gjithashtu në këshill mund të ketë magjistratë të komanduar sipas neneve 40 dhe 53.

Pra në këtë pikë në fund mund të shtohet togfjalëshi **“ose në vendin ku ka emërimin”**, duke e lënë të hapur mundësinë e angazhimit të tij.

Propozimi Nr.11

Neni 47, pika 3

Në lidhje me referimin në pikën 1 të po të njëjtit nen, **nuk kuptojmë qëllimin e këtij referimi.**

Propozimi Nr.12

Neni 47, Pika 6

Gërma C) pika i). **Shtohet termi “kryetar” në fillim të fjalisë** pasi mund të kemi raste të konkurrimit të personave që kanë qenë më parë kryetarë me ligjin e vjetër. Mos paraqitja e këtij termi duket si përjashtuese.

Propozimi Nr.13

Neni 59, pika 8

Gjykojmë që fjalia e parë mund të plotësohet për të qenë më e qartë duke u bërë :

“Kur një pozicion është përkohësisht i lirë, për jo më shumë se 3 muaj, ai mund të plotësohet vetëm përmes caktimit të përkohshëm të magjistratit.”

Shtuar pjesa me të zeza pasi termi “vetëm” mund të krijojë konfuzion ne raport me transferimin e përkohshëm.

Propozimi Nr.14

Ndryshimi i pikës 3 të nenit 146. (Arsyetimi i vendimit me shkrim nga Komisioni i disiplinës dhe Këshilli)

Për shkak të problematikave të hasura deri tani në lidhje me vendimet në rastin e procedimeve disiplinore ka lindur e nevojshme ndryshimi i pikës 3 të nenit 146. Arsyeja kryesore vjen për shkak të karakterit kompleks dhe voluminoz që kanë këto çështje disiplinore (*mesatarisht prej 2000 faqesh*) dhe mënyrës së organizimit të afateve të mbledhjeve të komisioneve dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Sikurse dihet, projekt-aktet i njoftohen Komisionit përkatës jo më vonë se 1 (një) javë nga data e parashikuar për mbledhjen plenare. I njëjti afat parashikohet edhe për mbledhjet plenare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

vendosjen e masave disiplinore ndaj prokurorëve është një e drejtë ekskluzive e Këshillit, dhënë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë mbi bazën e neneve 149 dhe 149/a të saj.

Vendimmarrja e KLP-së, ushtrohet në kuadër të një procesi të rregullt nga pikëpamja procedurale, duke garantuar respektimin e parimeve për një proces të rregullt administrativ. Kjo vendimmarrje, duke pasur parasysh edhe konfigurimin strukturor të Këshillit (*6 anëtarë prokurorë dhe 5 joprokurorë që vijnë nga fusha të ndryshme*) shtrihet përtej vlerësimit apo kualifikimit si shkelje disiplinore të një sjellje të caktuar. Ajo ndikohet në mënyrë të pashmangshme edhe nga detyrat dhe funksionet e tjera të KLP-së, në kuadër të menaxhimit apo administrimit të sistemit të Prokurorisë në tërësinë e tij, veçanërisht ato që lidhen me sistemin e vlerësimit dhe të karrierës. Seicili anëtar i Këshillit merr vendimet e tij, mbi bazën e bindjes së tij të brendshme e cila normalisht mund dhe duhet të lidhet me grupin e interesit të cilin seicili prej anëtarëve përfaqëson dhe nga i cili është zgjedhur në këtë Këshill. Ky ka qenë edhe qëllimi i këtij konfigurimi të përbërjes së KLP-së sanksionuar nëpërmjet normave Kushtetuese. Për këto arsye **Gjykata Administrative e Apelit gjithmonë sipas vlerësimit tonë nuk mund dhe nuk duhet të marrë kompetencën e vendosjes së masave disiplinore ndaj magistratëve**, kompetencë e cila deri më sot është ushtruar vetëm nga KPK-ja (në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar), Këshillat (KLP-ja dhe KLGJ-ja), si dhe nga KPA-ja, si i vetmi organ i cili sipas Kushtetutës ka juridiksion disiplinor ndaj magistratëve.

Edhe vetë procesi i rivlerësimit kalimtar, pjesë e reformës në drejtësi, është hartuar mbi bazën e parimit se çështjet disiplinore shqyrtohen nga organe të posaçme sikurse është KPK-ja, dhe ankimohen në KPA, organe të cilat nuk duhet dhe nuk mund të jenë pjesë e sistemit gjyqësor.

Për të njëjtën arsye, edhe procedimet disiplinore të zhvilluara në bazë të ligjit Nr. 96/2016, “Për Statusin ...” zhvillohen nga organe si KLP-ja dhe KLGJ-ja, të ngritura mbi bazën e po të njëjtës pakete ligjesh që normojnë atë që quhet reformë në drejtësi, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë sistemit gjyqësor, për të garantuar objektivitet në gjykim dhe shmangur edhe konfliktin e mundshëm të

interesit (në këtë rast të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit). Në këto kushte, për të ruajtur të njëjtin standard me masat disiplinore të dhëna nga KPK-ja, edhe ankimimet ndaj vendimeve disiplinore duhet të gjithashtu të shqyrtohen nga KPA-ja.

Në të kundërt Gjykata e Administrative e Apelit do të gjendet në të ardhmen përpara vlerësimit të sjelljes profesionale të gjyqtarëve të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar sipas rastit edhe zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e Gjykatës së Lartë apo për më tepër paaftësinë e dukshme profesionale të tyre (sipas përcaktimeve të nenit 101, pika 1 germa b) e ligjit Nr.96/2016, “Për Statusin” i ndryshuar”, ndërkohë që nga ana tjetër është e detyruar të zbatojë pikërisht këto vendime të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në të cilën Gjykata Administrative e Apelit ka konstatuar se janë marrë në shkelje të rëndë të ligjit.

Nga ana tjetër para cilës gjykatë do të ankohej magjistrati nëse eventualisht masën disiplinore e jep Gjykata Administrative e Apelit. (normalisht vendimi i gjykatës ankimohet në një gjykatë më të lartë pra në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë). D.m.th, nëse e njëjta masë disiplinore do jepej nga Këshillat, gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit do ishte Gjykata Kushtetuese nëpërmjet KPA-së si dhomë e kësaj gjykate, ndërsa në rast se për të njëjtën çështje, e njëjta masë disiplinore do jepej nga gjykata administrative e apelit, po i njëjti magjistrat do ankohej në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Në vlerësojmë se ligjvënësi nuk mund të ketë zgjidhur në mënyrë konfuzë një të drejtë kaq themelore siç është e drejta e ankimit të palëve ndaj një vendimi me karakter disiplinor.

Në lidhje me ndryshimin në ligjin “Për Statusin” të cilat bëhen të detyrueshme sipas propozimit të mësipërm vlerësojmë se:

Në Pjesën e VI, “Dispozita të fundit dhe kalimtare”, të Ligjit Nr.96/2016, i ndryshuar, të shtohet një nen i ri, me Nr.164/1, i titulluar “Bursa e shkollimit dhe praktika profesionale për kandidatët magjistratë në periudhën tranzitore”, me këtë përmbajtje:

Neni 164/1

Bursa e shkollimit dhe praktika profesionale për kandidatët për magistratë në periudhën tranzitore

1. *Kandidati për magistrat, i cili pranohet të ndjekë kursin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në periudhën tranzitore, përfiton bursë shkollimi sipas këtyre treguesve:*
 - a) *në vitin e parë 30 për qind të pagës bruto fillestare të tij;*
 - b) *në vitin e dytë 45 për qind të pagës bruto fillestare të tij.*
2. *Rregullat e tjera të nenit 19, të këtij ligji do të zbatohen për kandidatët për magistratë në periudhën tranzitore.*
3. *Kandidatët gjyqtarë dhe kandidatët prokurorë të kryejnë praktikën profesionale në periudhën përkatëse të vitit të dytë të Programit Fillestar, në periudhën tranzitore, sipas rregullave të nenit 33, të këtij ligji.*
4. *Rregullat e tjera që kanë të bëjnë me trajtimin e kandidatëve për magistratë sipas këtij ligji, zbatohen në mënyrë proporcionale edhe për kandidatët për magistratë në periudhën tranzitore.*

11. Shfuqizimi i parashikimit ligjor për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës për të diplomuarit në Shkollën e Magjistraturës

Në nenin 148/ç, pika 1, të Ligjit Nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.”

Në nenin 34, pika 1, të Ligjit Nr.96/2016, i ndryshuar, parashikohet detyrimi i Këshillave për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës, në përputhje me rregullat e nenit 32, të këtij ligji.

Ndërsa, në nenin 35, pika 1, të këtij ligji, përcaktohen kriteret për emërimin e kandidatëve magjistratë të diplomuar, ku thuhet se:

“1. I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere:

a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme;

b) është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar;

c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.”

Praktika e deritanishme e Këshillave tregon për vonesa të konsiderueshme në kohë për emërimin e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës, si magjistratë dhe caktimin e tyre në pozicion. Këto vonesa janë shkaktuar kryesisht nga koha e gjatë për verifikimin e pasurisë dhe figurës si dhe kthimi i përgjigjeve nga organet ndihmëse sipas nenit 32, pika 2, të këtij ligji (ILDKPKI, organet tatimore dhe doganore, zyrat e prokurorisë, etj). Vonesat e shkaktuara kanë rezultuar në kosto financiare të ndjeshme të vendosura nga vendimet gjyqësore në shqyrtim të ankimeve të të diplomuarve të emëruar me vonesë për shkakun e mësipërm.

Përsa i përket emërimit të studentëve si magjistratëve prokurorë, pas diplomimit të tyre, Këshilli i Lartë i Prokurorisë kryen verifikimin e pasurisë dhe të figurës për çdo kandidat për prokuror përpara se të filloj programin e formimit fillestar dhe pasi përfundon me sukses këtë program. Në praktikë është konstatuar që për shkak të procesit të rivefikimit të pasurisë dhe figurës, krijohet artificialisht një vonesë ku kandidatët për prokuror nuk mund të emërohen pa u ri kryer sërish verifikimi i cili ndërvohet nga disa institucione të tjera, duke bërë që vakancat në sistem të mbeten të paplotësuara dhe për më tepër të rëndojë edhe një faturë financiare për mos emërimin në kohë të magjistratëve të rinj.

Konkretisht për prokuror për vitin 2018, ka rezultuar se 6 kandidatët për prokuror, të cilët kanë përfunduar me sukses vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, janë mundur të emërohen nga KLP-ja vetëm në Korrik të vitit 2019, pra pas një viti nga momenti i diplomimit;

Kandidatët për prokuror që kanë mbaruar shkollën në Korrik të vitit 2019 janë emëruar në Shkurt të vitit 2020, pra pas 7 muajsh nga momenti i diplomimit;

Kandidatët për prokuror të cilët kanë përfunduar studimet në Korrik të vitit 2020, janë emëruar në tetor të vitit 2020, pra pas 4 muajve nga momenti i diplomimit.

Sikurse shihet vonesat për përfshirjen në sistem të të diplomuarve kanë qenë të konsiderueshme, në raport me nevojën imediatë që paraqitet në këtë moment, pra përmendur këtu edhe një faturë financiare e shprehur si detyrim i vendosur nga gjykata, për pagesën e pagave të këtyre të diplomuarve nga momenti i diplomimit deri në emërimin e tyre. (në total 150 paga bruto të kategorisë G3 në një vlerë totale).

Duke ju referuar edhe praktikës së deri tanishme nuk ka rezultuar në asnjë rast që një kandidat për prokuror të ketë ngelur gjatë filtrit të verifikimit që Këshilli ka bërë pas diplomimit. Mendojmë që duhet të jetë e njëjta situatë edhe për KLGJ-në.

Për këtë shkak, duke u nisur nga burimet e kufizuara njerëzore por edhe nga fakti që pranimi në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, kandidatët për prokuror kanë kaluar me sukses verifikimin fillestar të pasurisë dhe të figurës si dhe janë në mënyrë vazhduese objekt kontrolli nga Komisioni Disiplinor i Shkollës së Magjistraturës, jemi të mendimit që ri-verifikimi pas diplomimit duhet të shfuqizohet me qëllim përfshirjen në sistem sa më parë të këtyre magjistratëve.

Për të shmangur vonesat në emërimin si magjistratë, kostot financiare që shoqërojnë këtë proces sipas rregullimit aktual ligjor, duke patur parasysh faktin se kandidatët për magjistratë verifikohen përpara se të pranohen në Formimin Fillestar të Shkollës së Magjistraturës si dhe gjatë çdo procesi të ngritjes në detyrë sipas këtij ligji, faktin se magjistratët janë subjekt i deklarimit të pasurisë sipas Ligjit Nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, sugjerojmë heqjen e kushtit ligjor për verifikimin e pasurisë dhe figurës për të diplomuarit në Shkollën e Magjistraturës.

Për miratimin e këtij propozimi, sugjerojmë ndryshimet në ligjet si vijon:

Neni 1

Neni 148/ç, pika 1, e Ligjit Nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ndryshohet si vijon:

“1. Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit.”

Në Ligjin Nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

1. Në nenin 34, pikat 1 dhe 1/1, shfuqizohen.

2. Në nenin 34, shtohet pika 1 si vijon:

“1. Çdo vit, deri në fund të muajit qershor, Shkolla e Magjistraturës publikon listën e kandidatëve magjistratë, të diplomuar në formimin fillestar gjatë atij viti.”

Neni 2

Në nenin 35, pika 1, shfuqizohet germa “c”.

12. Shtimi i funksionit të “këshilltarit ligjor” në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Qëllimi i këtij propozimi është shtimi i funksionit të “këshilltarit ligjor” në strukturën e zyrave të prokurorisë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

Aktualisht, funksioni i “këshilltarit ligjor” parashikohet si pjesë e Njesisë së Shërbimit Ligjor vetëm për zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm referuar nenit 2, germa “dh”, nenit 65, pika 1, germa “d”, nenit 69, pikat 1, 2 dhe 3, nenit 70, pika 1, germa “a”, nëngerma “a/1”, nenit 72, pika 2 dhe nenit 76, pika 1/1, të Ligjit Nr.97/2016, i ndryshuar.

Në nenin 69, pikat 1-5, të këtij ligji, parashikohet organizimi i Njesisë së Shërbimit Ligjor, përgjegjësitë e këshilltarëve dhe statusi i prokurorëve (magjistratë) të komanduar si këshilltarë nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në këto pika të nenit 69 parashikohet se:

“1. Pranë Prokurorisë së Përgjithshme funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor.

2. Ajo ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Prokurorisë së Përgjithshme duke përfshirë:

a) analizimin, studimin e ankimeve dhe dosjeve penale;

b) përgatitjen e relacioneve për çështjet objekt gjykimi përpara Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese;

c) kryerjen e kërkimeve ligjore;

ç) përgatitjen e projektakteve;

d) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjeve që i ngarkohen nga Prokurori i Përgjithshëm.

3. Njësia e Shërbimit Ligjor është në varësi të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili cakton këshilltarin ligjor pranë një prokurori ose drejtorie në Prokurorinë e Përgjithshme, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe specializimin e tyre, si dhe duke siguruar ngarkesë pune të barabartë ndërmjet tyre.

4. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarët ligjorë, në të cilën më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5. Prokurorët e komanduar caktohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në Prokurorinë e Përgjithshme sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Statusi i prokurorëve të komanduar përcaktohet në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.”

Ndërsa, në pikat 7 dhe 8, të nenit 69, përcaktohet mënyra e emërimit të këshilltarëve ligjorë (jomagjistratë), trajtimi me pagë dhe kriteret ligjore për t'u emëruar në këtë funksion.

Për shtimin e funksionit të “këshilltarit ligjor” në strukturën e zyrave të prokurorisë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm është e nevojshme që të bëhen ndryshime në dispozitat e mësipërme, si vijon:

C- PROPOZIME PER NDRYSHIME NË LIGJIN NR.97/2016, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.

1. Në nenin 2, germa “dh”, pas togfjalëshit “Prokurorisë së Përgjithshme” shtohet togfjalëshi “dhe prokurorive me juridiksion të përgjithshëm”.
2. Në nenin 69, pika 1, pas togfjalëshit “Prokurorisë së Përgjithshme” shtohet togfjalëshi “dhe prokurorive me juridiksion të përgjithshëm”.
3. Në nenin 69, pika 2, pas togfjalëshit “Prokurorisë së Përgjithshme” shtohet togfjalëshi “dhe prokurorive me juridiksion të përgjithshëm”.
4. Në nenin 69, pika 3, pas togfjalëshit “në Prokurorinë e Përgjithshme” shtohet togfjalëshi “dhe në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.
5. Në nenin 69, pika 4, bëhet si vijon:
“4. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarët ligjorë, në të cilën më pak se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
6. Në nenin 70, pika 1, germa “a”, nëngerma “a/1”, pas togfjalëshit “në Prokurorinë e Përgjithshme” shtohet togfjalëshi “dhe në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

7. Në nenin 72, pika 2, pas togfjalëshit “në Prokurorinë e Përgjithshme” shtohet togfjalëshi “dhe në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.
8. Në nenin 76, pika 1/1, pas togfjalëshit “në Prokurorinë e Përgjithshme” shtohet togfjalëshi “dhe në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

D- PROPOZIME PËR NDRYSHIME MBI LIGJIN NR.95/2016 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR

M

Neni 12, pika 3, i Ligjit Nr.95/2016, citon se: “Prokurorët emërohen në detyrë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për një mandat nëntëvjeçar. Mandati pezullohet apo ndërpritet vetëm nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkon procedim disiplinor kundër prokurorit”.

Paragrafi i dytë duhet hequr ose duhet të riformulohet, pasi bie ndesh me nenet 151, 152 pika 1, 110 dhe 111 të ligjit 96/2016., “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilat sanksionohen në mënyrë të qartë rastet e pezullimit të detyruar, pezullimin në funksion të zhvillimit të procedimit disiplinor (vendim i ndërmjetëm i Këshillit), pezullimin si masë disiplinore si dhe rastin e ndërprerjes së mandatit si rezultat i shkarkimit si masë disiplinore.

E- PROPOZIM PËR STATUSIN E ANËTARËVE JOPROKURORË PAS PËRFUNDIMIT TË MANDATIT (3-5 VJEÇAR)

Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ndejmë veten të privilegjuar dhe njëkohësisht më një përgjegjësi të madhe mbi supe, që janë pjesë e institucioneve të reja të Reformës në Drejtësi, implementimi i së cilës do të mundësojë

konsolidimin e shtetit të së drejtës, kthimin e besimit të shtetasve tanë te Sistemi i Drejtësisë në vend.

Qëllimi i Reformës në Drejtësi është realizimi i të drejtave kushtetuese dhe ligjore të shtetasve përmes një sistemi drejtësie të pavarur, të paanshëm dhe eficient. Sistemi i drejtësisë, përmes institucioneve të reja që e përbëjnë atë si, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, KLGJ¹, KED², ILD, etj., duhet të sigurojë zbatimin e parimeve kushtetuese si; ***të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe se, sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor***³.

Formatimi kolegjal si dhe mënyra e zgjedhjes apo funksionimit të organeve të drejtësisë pengon ndikimin apo përdorimin e tyre nga pushtetet e tjera, si ai legjislativ apo ekzekutiv. Gërshetimi dhe balancimi i kompetencave ligjore që u përkasin këtyre organeve, mundëson që secili prej tyre të veprojë i pavarur në rolin që ka në sistemin e drejtësisë. E rëndësishme mbetet që kjo pavarësi të jetë e qëndrueshme, të jetë realitet në praktikë dhe jo afirmim formal dhe teorik, duke ruajtur kështu frymën dhe qëllimin e Reformës në Drejtësi.

Në hartimin e legjislacionit të Reformës në Drejtësi, i është kushtuar vëmendje statusit dhe mandatit të magistratit si dhe të emëruarve në këto institucione pikërisht për të garantuar një pavarësi të qëndrueshme, eficiente, të aktorëve të sistemit të drejtësisë në mënyrë që të kemi rezultate të prekshme në luftimin e pandëshkueshmërisë dhe dhënien e drejtësisë njësoj për të gjithë shtetasit, pa dallim për shkak të funksionit shtetëror apo pozitës social-ekonomike.

Në këtë kuadër, vëmë re se legjislatori në rastin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, anëtarët e Komisionit të Posaçëm të Apelit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka parashikuar një rregullim ligjor i cili i garanton atyre caktimin në detyrë si gjyqtar apo prokuror apeli. **Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë të vetmit funksionarë të Sistemit të Drejtësisë, për të cilët nuk parashikohet një rregullim i tillë i cili do t'i garantonte**

¹ Këshilli i Lartë Gjyqësor

² Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

³ Nenet 7 dhe 18/1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

vazhdimësinë e tyre në sistem si një garanci e domosdoshme për paanshmërinë, efikasitetin dhe pavarësinë e tyre.

Në këto kushte i propozojmë Kuvendit alternativat ligjore të cilat do të mundësonin vazhdimësinë e shërbimit në sistemin e drejtësisë të anëtarëve të Këshillit pas përfundimit të mandatit, si më poshtë;

Alternativa e parë: "Pas përfundimit të mandatit dhe me kërkesë të tij, anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët joprokurorë emërohet gjyqtar në gjykatën e apelit.

Në vazhdim të argumentave me lartë, vlen të theksojmë dhe një argument tjetër të rëndësishëm, siç është boshllëku që po krijohet në radhët e magjistratëve si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar (Veting-u). Nisur nga ky fakt rezulton që për një periudhë 10 vjeçare sistemi do të ketë nevojë për burime njerëzore të cilat zor se mund të mbulohen me kapacitetet aktuale të Shkollës së Magjistraturës, ndaj qëndrimi në sistem i funksionarëve të lartë të drejtësisë është një vlerë e shtuar në këtë moment.

Propozojmë parashikimin ligjor;

Alternativa e dytë: Dispozitë kalimtare. "Për një periudhë 10 vjeçare nga data e konstituimit të KLP-së, anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët joprokurorë, në përfundim të mandatit dhe me kërkesë të tij emërohet gjyqtar në gjykatën e apelit.